



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e Kryetarit



Nr. Prot. 499

Datë: 3. 9. 2019

Duke u bazuar në nenin 12, 45 dhe 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Npi - 01/247 datë: 30.08.201 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008): Ligjin për Qasje ne dokumente ke Nr.05/L-215: Udhëzimin Administrativ të MAPL-së për Transparence ne Komuna O1/20015; Neneve 14-21 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636, date 03.09.2008; dhe Rregulloren Komunale mbi Transparencën 01Nr.006/10911-144, date: 30.04.2014; Zyra e Kryetarit/Zyra për Informim shpallë këtë:

NJOFTIM PËR DEBAT PUBLIK ME QYTETARË

**DRAFT – PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN E SHTIMES
2019 - 2023**

Njoftojmë qytetarët e komunës së Shtimes, se Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 8. 2019, ka marrë vendim që të nxjerrë në Diskutim Publik **Draft – Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Shtimes, 2019 – 2023.**

Duke u bazuar në këtë vendim të Kuvendit, Zyra e Kryetarit, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, organizojnë **Diskutimin Publik** (debat me qytetarë) më:

Më datën, **17. 9. 2019** (ditë e martë),

Në ora **15:00** - **Diskutimi Publik me qytetarët e komunës së Shtimes, Shoqëri Civile, Subjekte Politike etj.**

Debati do të mbahet në ndërtesën e Komunës së Shtimes, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Ftojme qytetarët e Komunës së Shtimes, përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, shoqërinë civile dhe të tjerët që të kontribuojnë me pjesëmarrjen e tyre në këtë debat, gjithashtu mund të kontribuojnë duke na shkruar edhe në adresën elektronike: info.shtime@rks-gov.net

Draft – Planin e Veprimit për Transparencë në Komunën e Shtimes, 2019 – 2023, për Komunën e Shtimes mund ta shkarkoni nga uebfaqja zyrtare e komunës: kk.rks-gov.net/shtime ose mund ta merrni si kopje fizike në Zyrën për Informim.

Kryetari i Komunës, Naim Ismajli

